

Viti i ri akademik në FASTIP

Nis viti i ri akademik në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën. Gjatë dy viteve FASTIP-i ka rezultuar shumë i suksesshëm në programin e Menaxhimit të Bankave; ky është dhe vlerësimi i dy partnerëve tanë, BKT dhe

bankës CREDINS. Këtë vit i është bashkangjitur programit në fushën e Menaxhimit të Bankave dhe Raiffeisen Bank.

Për herë të parë në auditoret komode të FASTIP-it janë ulur edhe studentët që vazhdojnë studimet në programet e studimit në degët Menaxhim i Hoteleri & Turizmit dhe Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

U urojmë studentëve tanë suksese në mësimet dhe performancë të shkëlqyer në trajnimin e tyre praktik në kompanitë partnere të FASTIP.



*Prof.as.dr. Mit'hat Mema
Rektor i UAMD*

Pas dorëheqjes nga detyra e rektorit Prof. dr. Agim Kukeli, më 12.11.2010 në Universitetin e Durrësit u mbajtën zgjedhjet për rektorin e ri. Këto zgjedhje u fituan nga prof. asoc. dr. Mit'hat Mema deriatëherë zv/rektor i Universitetit. Bazuar në VKM-në nr. 827 datë 11.06.2008 për hapjen e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, ai është njëherësh edhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit tonë.

Takim i Hapur "FASTIP-Biznes-Studentë"

Ditën e Mërkurë datë 27 Tetor 2010 ora 10:00, në ambjentet e FASTIP-it u mbajt takimi i hapur "FASTIP - Biznes-Student" me qëllim vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes FASTIP-it, bizneseve dhe studentëve.

Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të bizneseve që e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e Hoteleri & Turizmit dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Fjala e hapjes u mbajt nga dekani i fakultetit Doc. Vladimir Muka. Më pas takimi vazhdoi me prezantimin e filozofisë së FASTIP-it nga përgjegjësat e departamenteve dhe prezantimin e modelit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Kancelari, z. Mentor Isufaj. Të pranishmit në takimin e hapur u njohën dhe me mbështetjen gjermane që ofrohet në FASTIP nga ekspertët të CIM-it dhe GOPA-s. Në takim u shkëmbyen përshtypje mbi eksperiencën e deritanishme të bashkëpunimit nga përfaqësues të bankave dhe studentëve.



FASTIP-i, njëherësh sfidë dhe mundësi për biznesin



Andrea Xhavora

Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Durrës

U bënë tre vjet që në Universitetin “A.Moisiu” në Durrës është hapur FASTIP-i, një fakultet i veçantë, në të cilin studimet teorike integrohen me praktikën. Ky fakultet është ngritur sipas një modeli mjaft të përhapur në Gjermani, një nga tre vendet më të zhvilluara të botës. Kërkesa këmbëngulëse dhe e argumentuar e biznesit ka realizuar atje këtë tip shkollë të lartë, si një partneritet i shtetit me biznesin privat. Ky partneritet arrin të mbulojë kosto për studentët, disa herë më të larta se ato në universitetet e tjera, duke siguruar një profesorat të nivelit të lartë, të mbështetur me laboratore dhe logjistikë nga më të përparuarit.

A do të kishte sukses “importimi” i këtij modeli gjerman në një vend në zhvillim si Shqipëria? Një përgjigje e menjëhershme iu dha kësaj sfide nga sektori bankar. Dega *Manaxhim Bankar* në FASTIP, Durrës ka tashmë 76 studentë, të cilët ndjekin studimet në tri kurset e tij, duke u mbështetur te BKT-ja dhe CREDINS, si për praktikën, ashtu dhe për pagesën e lektorëve anglisht-folës, pothuaj që të gjithë të huaj e të nivelit të lartë.

Ndërkaq, pas dy vite heshtje, vjen dhe reagimi i parë nga sektori i NVM-ve: afro 50 studentë kanë filluar studimet në FASTIP, në degët *Manaxhim Biznesi* dhe *Manaxhim Turizëm*. Ky fakt tregon se edhe ndërmarrjet e vogla e të mesme po lëvizin në drejtimin e duhur, zhvillimin e burimeve njerëzore të harmonizuara me nevojat e vetë biznesit. Natyrisht, studimet në FASTIP garantojnë më tepër se çdo fakultet tjetër, staf të përgatitur për të rritur aftësinë konkurruese të NVM-ve shqiptare në tregun global të sotëm. E vërteta është se studentët e rinj e kanë kuptuar se FASTIP-i është një mundësi e shkëlqyer për karrierën e tyre të ardhme, gjë që kuptohet nga kërkesat e tyre të shumta këtë vit. A do të jetë edhe biznesi po aq kërkues dhe i interesuar për të mbështetur studimet e këtyre studentëve? Ne shpresojmë se ata do ta shohin FASTIP-in jo vetëm si një **sfidë**, por njëherësh edhe si një **mundësi** për rritjen e biznesit të tyre, që është dhe baza e rritjes ekonomike e të gjithë vendit tonë.

FASTIP-i në panairin “Work & Study”

Në datat 17-19 Shtator 2010 Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, organizoi në ambjentet e Pallatit të Kongreseve panairin “Work and Study”.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë universitete private shqiptare, agjensi punësimi dhe kompani të ndryshme shërbimesh.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm znj. Nora Malaj, zv/Ministre e Arsimit dhe Shkencës dhe znj. Filloreta Kodra zv/Ministre e Punës,

Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Pjesëmarrja e FASTIP-it në këtë panair u mundësua falë mbështetjes së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, nën kujdesin e veçantë të kryetarit z. Nikolin Jaka. Gjatë konferencës së mbajtur rreth panairit, vëmendje e veçantë iu kushtua promovimit të FASTIP-it, si risi në arsimin e lartë publik shqiptar. Gjatë fjalës së tyre pjesëmarrësit në konferencë theksuan suksesin e deritanishëm midis sektorit

publik dhe atij privat, që siguron Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.

Në mbyllje të këtij panairi, përveç promovimit të fakultetit u arritën edhe rezultate konkrete bashkëpunimi.

Universiteti i Durrësit me Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktikën ishte i vetmi universitet publik që mori pjesë në këtë aktivitet falë mbështetjes së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë.





Norbert M. Marx

Ekspert, Këshilltar pranë Dep. të Menaxhimit të Bankave



Eksperienca e një jete, në ndihmë të FASTIP-it

Norbert M. Marx është në pozicionin e Këshilltarit pranë departamentit të Bankave në FASTIP që nga tetori 2009.

Norbert M. Marx ka një eksperiencë pune shumë intensive në ekonomi, menaxhim banke dhe inxhinieri financiare, tregti ndërkombëtare, në zhvillimin strategjik të biznesit, në politikat për zhvillimin e NVM-ve, etj. Baza e tij profesionale dhe ekspertiza solide përfshin menaxhimin e projekteve, planifikimin e investimeve, zhvillimin e politikave nacionale dhe rajonale, etj.

Që nga viti 1981 ai ka qenë drejtues i shumë projekteve të qeverisë gjermane dhe përgjegjës në më shumë se 30 shtete të botës, për qeveritë e atyre shteteve, organizata ndërkombëtare dhuruesish, banka, ndërmarrje, për zhvillimin e burimeve njerëzore, etj.

Doc. Marx ka më shumë se 20 vjet eksperiencë në mësimdhënie dhe më shumë se 30 vjet si menaxhues i trajnimeve, eksperiencia këto të fituara në shumë shtete të botës si: Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mynih/Gjermani, Spanjë, Republikën Çeke, Hungari, Lituani, Kinë, Filipine, Rusi, Guatemalë, Kenia, Afganistan, Indonezi.

Gjthashtu Z. Norbert M. Marx është autor i shumë artikujve, librave, publikimeve rreth ndërmarrjeve, organizimit të zyrës, inxhinierisë financiare dhe bankave, cilësisë në menaxhimin e hoteleve dhe restoranteve, teknologjisë së IT-së dhe medias së re, e-learning etj.

Këndi i studentëve



Përshëndetje, unë quhem Enos Dauti dhe jam student pranë FASTIP-it në vitin e dytë dega Menaxhim Banke. Së pari dua t'ju falenderoj për mundësinë që më jepni për të thënë diçka rreth marrëdhënies sime me këtë fakultet. Unë më parë kam qenë student i fakultetit të Shkencave Sociale, dega Psikologji për një vit akademik, dhe krejt rastësisht dëgjova për

FASTIP-in dhe u bëra student këtu. Ky fakultet përbën një sfidë tërësisht të re, e cila të prezanton me aspekte akademike të cilat mungojnë në vendin tonë për fat të keq, por që nga ana tjetër të dhuron një të ardhme profesionale të qëndrueshme duke të kërkuar të nxjerrësh më të mirën nga vetja.

Perspektiva Ndërkombëtare



Liang-Shing Fan,
Ph.D. Profesor i ftuar

Profesor Emeritus i ekonomisë nga Colorado State University, ShBA, fitues i shumë çmimeve honorike ndërkombëtare dhe autori i shumë librave dhe botimeve në ShBA dhe Azi në fushën e ekonomisë, vjen për të dhënë mësim në FASTIP për të dytin vit radhazi.

Profesor Fan ka një eksperiencë më shumë se 42 vjecare në mësimdhënie dhe është hera e parë që jep mësim në një fakultet dual. Ai shprehet se mësimi në FASTIP është shumë intensiv; përpiqet të bëjë më të mirën e tij në mënyrë që studentët të absorbojnë maksimumin e leksioneve por studentët e FASTIP-it kanë avantazhin se sëbashku me mësimin ata kanë mundësinë që të akumulojnë dhe eksperincën në punë, pavarësisht nga fakti se kanë dhe punën e siguruar.



Akreditimi Ndërkombëtar



Dr. Lutz Neumann

Profesor i Matematikës & Statistikës në Berufsakademie (Universitetin Dual) të Breitenbrunn-it (Gjermani) dhe Ekspert në Akreditimin Ndërkombëtar

Dr. Lutz Neumann punoi në FASTIP si konsulent i GOPA-s për Akreditimin Ndërkombëtar nga data 31 tetor deri më 6 Nëntor 2010. Detyra e tij kryesore ishte analizimi i situatës aktuale dhe këshillimi për përgatitjen e fakultetit për akreditimin sipas standarteve ndërkombëtare.

Pse akreditimi ndërkombëtar është shumë i rëndësishëm për arsimin e lartë?

“Akreditimi ndërkombëtar është shumë i rëndësishëm për të gjitha universitetet, studentët e tyre, stafin akademik dhe për vetë imazhin e institucionit. Një universitet i akredituar tregon që ai përmbush standartet ndërkombëtare të mësimdhënies dhe cilësisë. Ai u lejon studentëve të studiojnë për një kohë të shkurtër në çdo universitet të botës nëpërmjet transferimit të krediteve të këto universitete. Studentët mund të vazhdojnë studimet pasuniversitare, ose të punojnë në çdo shtet tjetër sepse u njihet diploma.”

Si mund të realizohet një akreditim i tillë për FASTIP-in?

“FASTIP-i tashmë është në vitin e tretë të jetës por para se të aplikojë për një akreditim të tillë duhet bërë shumë punë. Çështje esenciale të cilat duhen përmbushur para aplikimit për akreditimin ndërkombëtar janë: situata financiare e qëndrueshme, biblioteka e mirëpajisur si dhe profesorët me kohë të plotë, me eksperiencë praktike dhe shkencore.

Stafi i lektorëve të ftuar është një avantazh për zhvillimin e mësimdhënies. Vlen për t’u përmendur ndihma shumë e vlefshme e z. Marx për institucionin, sepse ai ka shumë eksperiencë dhe kontaktet e nevojshme. Ka dhe aspekte të tjera që duhen marrë parasysh si psh. siguria e rrjetit.

Qëllimi i akreditimit mund të arrihet nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të standarteve edukative të FASTIP-it brenda tre viteve të ardhshme. Një bashkëpunim i ngushtë me Universitetin Dual të Breitenbrunn-it, mund të ndihmojë në arritjen e këtij qëllimi, sepse ky universitet është i akredituar dhe mund t’i japë FASTIP-it këshilla të vlefshme.”

Vështrim mbi kurrikulën e Menaxhimit të Hoteleri-Turizmit

Konceptimi dhe hartimi i kurrikulës në Degën Menaxhim Hoteleri –Turizëm është realizuar duke respektuar kërkesat që janë të prezantuara në Udhëzimin Nr.15 datë 04.04.2008 të MASH – it, në modelet e kurrikulave dhe eksperiencën e Fakulteteve të Studimeve Duale të njohura në Europë, si dhe duke mbajtur parasysh kërkesat e tregut sot.

Kurrikula përmban:

- Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) rreth 20% (36 ECTS)
- Disiplina të formimit karakterizues rreth 50% (90 ECTS)
- Disiplina formuese të ngjashme ose/dhe integruese me disipinat karakterizuese rreth 10% (18 ECTS)
- Disiplina formuese të zgjedhura nga studentët ndërmjet atyre që ofron institucioni 7-8% (12-14 ECTS)
- Vepërtari formuese për aftësime informatike rreth 10% (18 ECTS)
- Përgatitje e Tezës së Diplomës 3-4% (5-6 ECTS)

Mbështetur në Filozofinë e FASTIP-it kurrikula është e ndarë në gjashtë semestra nga të cilët çdo semestër përmban 12 javë teori (6 module) dhe 14 javë praktikë pranë kompanive.

Gjatë tre vite studimesh do të zhvillohen gjithsej 36 module.

Shpërndarja e moduleve sipas viteve është bërë duke mbajtur parasysh shkallën e vështirësisë të secilit modul. Kjo synon jo vetëm në shpërndarjen graduale të ngarkesës së secilit modul sipas viteve, por edhe në aftësinë e të nxëniet të materialeve studimore në mënyrë krijuese dhe praktike nga studentët.

Praktika është konceptuar si vendi i ndërthurjes së dy elementëve më të rëndësishëm të njohjes, vendi ku studenti jo vetëm vë në zbatim në sektorë të ndryshëm njohuritë e marra në modulet e zhvilluara, por kjo ofron edhe mundësinë e plotësimit të hapësirave të cilat jo në çdo rast i përmbush moduli.

Përgjegjëse e Departamentit të Menaxhimit të Hoteleri-Turizmit

Lindita Mukaj, MA

Buletini Informativ i FASTIP-it përmbledh informacionet më të rëndësishme si dhe mendime e përshtypje rreth fakultetit.

Ky Buletin Informativ del çdo tre muaj.

Përgatiti: Anduela Kaja

Redaktoi: Denata Nuellari

Kontakte:

Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën

Lagjja 17 Rruga “Adria” Durrës-Shqipëri

Tel+Fax: +355-52-22 44 16

Email: info@fastip.edu.al

web: www.fastip.edu.al